

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**PËR ASAMBLENE E SHOQËRISË EUROTEOREMA PEQIN SH.P.K.,**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Euroteorema Peqin sh.p.k., të cilat përbëhen nga Bilanci kontabel në datën 31 dhjetor 2014, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e metodave më të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare, pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësohen këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi, gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të shoqërisë Euroteorema Peqin sh.p.k. më 31 dhjetor 2014, të rezultatit të saj financiar, ndryshimeve në kapitalin e vet, dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2014, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.


AUDITUESI

Shoqëria AAP shpk.

Dashnor Çarçani

Rr. Sami Frasheri, Pallati 19, Hyrja 8, Kat 6, Ap. 18, Tiranë.

Maj 2015



BILANCI KONTABEL (Në 31 Dhjetor 2014)

AKTIVET	Shënime	31 Dhjetor 2014 Lekë	31 Dhjetor 2013 Lekë
Aktivitet afatshkurtra			
Mjete monetare	(2)	4,590,384	3,446,283
Aktive te tjera financiare afat shkurter	(3)	365,643,990	426,767,004
Inventar	(4)	87,177,636	97,014,039
Aktivitet totale afatshkurtra		457,425,350	527,227,326
Aktivitet afatgjata			
Investime financiare afatgjata		101,274,751	55,105,689
Aktive afatgjata materiale	(5)	858,657,544	844,548,641
Totali i aktiveve afatgjata		959,932,295	899,654,330
TOTALI I AKTIVEVE		1,417,344,305	1,426,881,656
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet afatshkurtra			
Huamarrje	(6)	256,631,044	247,740,614
Furnitorë	(6)	270,630,787	312,140,876
Personeli	(6)	18,564,362	19,958,894
Detyrime tatimore	(6)	38,750,299	33,859,773
Hua te tjera		-	92,527,293
Parapagime te arketuara	(6)	5,133,527	30,200,439
Detyrime të Tjera	(6)	4,116,302	4,116,302
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		593,826,321	740,544,191
Detyrimet afatgjata			
Hua afatgjata	(7)	150,720,580	235,478,828
Totali i detyrimeve afatgjata		150,720,580	235,478,828
TOTALI I DETYRIMEVE		744,546,901	976,023,019
Kapitali			
Kapitali aksionar	(8)	171,500,000	171,500,000
Rezerva ligjore		23,678,510	23,579,567
Rezerva te tjera		255,680,129	253,800,203
Fitime te pa shperndara		-	1,217,737
Fitimi i vitit financiar		221,938,765	761,130
Totali i kapitalit		672,797,404	450,858,637
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,417,344,305	1,426,881,656

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	2014 Lekë	2013 Lekë
Shitjet neto	(9)	1,479,592,167	377,225,003
Te ardhura te tjera (nga veprimtarite e shfrytezimit)	(9)	12,158,022	7,890,451
Te ardhura te tjera(pervec financiare)	(9)	-	7,453,034
Ndryshimet ne inventarin e produktit te gatshem e ne proces	(9)	3,615,625	13,673,665
Totali i të ardhurave		1,495,365,814	406,242,153
 Materialet e konsumuara	(11)	442,689,344	127,473,133
Furnitura e nentrajtime	(11)	491,085,081	128,874,999
Personeli	(10)	110,116,724	58,789,851
Amortizimi	(5)	72,358,511	25,137,369
Shpenzime të tjera	(11)	69,105,624	15,524,930
Totali i shpenzimeve		1,185,355,284	355,800,282
 Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit		310,010,530	50,441,871
 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		-38,678,922	-42,070,403
Fitimi (Humbja) nga kursi i këmbimit		1,348,972	-2,459,319
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		1,595	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-37,328,355	-44,529,722
 Fitimi bruto para tatimit		272,682,175	5,912,149
Fitimi i tatueshem		338,289,399	51,510,194
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(12)	50,743,410	5,151,019
 Fitimi neto i vitit financiar		221,938,765	761,130

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2014, Metoda Indirekte

Pasqyra e Fluksit monetar-metoda indirekte		2014	2013
	Shënime	Lekë	Lekë
Fluksi i parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		272,682,175	5,912,149
Rregullime për:			
Amortizimin		72,358,511	25,137,369
Ritje/ne tepricen e kërkesave të arketushme nga aktiviteti		61,123,014	2,052,198
Ritje në tepricën inventarit	(3)	9,836,403	-26,464,389
Ritje në tepricën/parapagime e shpenz të shtyra	(4)	-	-
Ritje në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	(6)	- 197,461,280	106,745,004
Paratë e përftuara nga aktiviteti		218,538,823	113,382,331
Interesi i paguar			
Tatim fitimi i paguar		-	-
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		218,538,823	113,382,331
Fluksi i parave nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(5)	- 91,333,335	-139,630,451
Te ardhura nga shitja e paisjeve		4,865,922	26,508,268
Investime afat gjata		- 46,169,062	41,321,198
Paraja neto, e përdorur në aktivitetet investuese		-132,636,475	-71,800,985
Fluksi i parave nga veprimtaritë financiare			
Te ardhura nga huamarrje afatgjata		-84,758,248	-39,609,685
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare		-84,758,248	
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		1,144,100	1,971,661
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		4,446,283	1,474,623
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		4,590,384	3,446,283

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin ushtrimor të mbylltur më 31 Dhjetor 2014

Lekë	Kapitali Aksionar	Prime te aksioneve	Aksione te Thesarit	Rezerva Ligjore & Statutore	Rezerva te Tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni ne 31 Dhjetor 2012	171,500,000	-	-	23,579,567	253,800,200	1,217,737	450,097,503
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	761,130	761,130
Dividente te paguar	-	-	-	-	-	-	-
Transferimi ne rezerva	-	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni ne 31 Dhjetor 2013	171,500,000	-	-	23,579,567	253,800,200	1,978,867	450,858,633
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	221,938,765	221,938,765
Dividente te paguar	-	-	-	-	-	-	-
Transferimi ne rezerva	-	-	-	98,943	1,879,923	(1,978,867)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni ne 31 Dhjetor 2014	171,500,000	-	-	23,678,510	255,680,123	221,938,765	672,797,397

Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtijre pasqyrave

SHËNIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN USHTRIMOR TE MBYLLUR NE 31 DHJETOR 2012

1. NATYRA E AKTIVITETIT DHE KUADRI KONTABËL I APLIKUAR**1.1.AKTIVITETI:**

EUROTEOREMA PEQIN SH.P.K është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregëtare me datë 15 Korrik 1993 me Vendim të Gjykatës Shkalles Parë Tirane Nr. 5629, me kapital të nënshkruar prej 171,500,000 leke, i ndarë në kuota me vlerë nominale 1.000 leke secila, me ortakë: Euroteorema srl, Torino, Itali me 70% të kuotave dhe shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë me 30% të kuotave. Adresa e shoqërisë është në Fushe-Mezë, ndertese 4-keteshe, Kashar, Tirane.

Shoqëria është licensuar në aktivitetin e Ndertim, Prodhim materialeve ndertimi e Inerte. Gjatë vitit 2014 shoqëria ka implementuar dhe zbatuar politikat fiskale në fushën e ndertimit dhe tregimit të materialeve të ndertimit në përputhje me Legjislacionin fiskal në fuqi.

1.2.Politikat kryesore kontabël:

Pasqyrat financiare janë hartuar dhe paraqitur mbështetur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë dhe Ligjin 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar. Monedha raportuese e pasqyrave është Leku shqiptar (Lek).

- a) **Aktivet Afatgjata Materiale:** Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret për njohjen si AAM në bilanc është bërë me kosto. Vlerësimi i mëposhëm është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të janë paraqitur në bilanc sipas vlerës së tyre neto (minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin, nëse ka).

Amortizimi vjetor është llogaritur sipas metodës me vlerë të mbetur për të gjitha grupet e AAM-ve, duke përdorur normat si më poshtë:

Grupet e AAM	Norma e amortizimit
• Ndertesa	5%
• Makineri e pajisje	20%
• Mjete Transporti	20%
• Mobilie orendi	20%
• Pajisje kompjuterike	25%
• Të tjera	20%

- b) **Inventari:** Gjendjet e inventarëve janë vlerësuar me kosto mesatare të ponderuar.
- c) **Llogaritë e arkëtueshme:** Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interesa dhe paraqiten me vlerën e tyre neto.
- d) **Të Ardhurat dhe Shpenzimet:** Të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë ekonomike janë raportuar sipas metodës së të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

- e) **Monedhat e huaja:** Transaksionet e kryera në monedhë të huaj janë konvertuar në Lekë me kursin e ditës së kryerjes së transaksionit, ndërsa gjendjet e të gjithë llogarive të mjeteve dhe detyrimeve në monedhë të huaj janë konvertuar në Lekë me kursin zyrtar në ditën e fundit të vitit të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat nga kurset e këmbimit janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në llogarinë përkatëse për ndryshimet nga kursi i këmbimit, sipas SKK.

Kursi i shpallur nga Banka Shqipërisë në 31 Dhjetor 2014, sipas monedhave përkundrejt lekut:

Monedha	31.12.2014	31.12.2013
EUR	140,14	140,20
USD	115,23	101,86

- f) **Tatimi mbi fitimin:** Shkalla e tatimi mbi fitimin për vitin ushtrimor 2014 është 15% sipas Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), neni 28.
- g) **Sigurimet shoqërore** janë llogaritur dhe paguar në përputhje me legjislacionin që vepron në këtë fushë.

2. AKTIVET MONETARE

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Banka	1,638,190	317,890
Arka	2,952,194	3,128,393
	4,590,384	3,446,283

Shoqëria ka llogari rrjedhese prane Intesa San Paolo Bank, Raiffeisen Bank, BKT Bank, Credins Bank, Procredit Bank, Veneto Bank, Emporici Bank, etj.

3. AKTIVE TE TJERA AFAT SHKURTERA

Aktive te tjera afatshkurtra analizohet sipas zerave ne tabelen e meposhteme:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente	299,472,392	393,437,882
Kerkesa te tjera te arketueshme	43,743,703	2,915,071
Instrumente te tjera borxhi (financim)	22,427,895	30,414,051
	365,643,990	426,767,004

4. INVENTARET

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Lende e pare dhe materiale ndihmese	23,551,456	37,003,484
Produkte te gatshme	63,626,180	60,010,555
	87,177,636	97,014,039

Inventari i mallrave gjendje ne 31 Dhjetor 2014, perbehet kryesisht nga lende e pare per ndertim, materiale ndihmese dhe produkte te gateshme.

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Gjendja e AAM-ve si dhe investimet në blerje të tyre gjatë vitit ushtrimor paraqiten në mënyrë analitike në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi	Toka	Makineri e paisje	Ndertime	Mjete transporti	Pajisje Informatike	Ndertim ne proces	Totali
Kosto historike							
Në 1 Janar 2014	15,425,800	414,418,010	14,709,242	70,882,930	21,113,004	504,619,196	1,041,168,180
- Shtesa		63,424,870		14,957,865	3,014,000	9,936,600	91,333,335
- Pakesime		4,948,395					4,948,395
Në 31 Dhjetor 2014	15,425,800	472,894,485	14,709,242	85,840,795	24,127,004	514,555,796	1,127,553,122
Amortizimi i akumuluar:							
Në 1 Janar 2014	-	146,719,947	8,729,407	32,980,962	8,189,224		196,619,540
- Shtesat	-	59,731,356	298,992	8,862,363	3,465,800		72,358,511
- Paksime	-	82,473					82,473
Në 31 Dhjetor 2014		206,368,830	9,028,399	41,843,325	8,189,224		268,895,578
Vlera kontabile neto:							
Në 31 Dhjetor 2014	15,425,800	267,698,063	5,979,835	37,901,968	12,923,780	504,619,196	844,548,641
Në 31 Dhjetor 2014	15,425,800	266,525,655	5,680,843	43,997,470	12,471,980	514,555,796	858,657,544

Normat e amortizimit te perdorura, jane ne perputhje me normat fiskale ne fuqi.

6. DETYRIME AFATSHKURTRA

Detyrime afatshkurtra analizohet sipas zerave ne tabelen e meposhteme :

• Huamarrjet

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Huamarje afat shkurter	256,631,044	247,740,614

- Zeri huamarje afatshkurtra ka pesuar rritje ne vleren 8,890,727 leke, te cilat i perkasin finacimeve te bera nga banka (ISP, RB) per likuiditete ne ndihme te aktivitetit operacional.

• Huat dhe parapagimet

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Furnitore	270,630,787	312,140,876
Detyrime personelit	18,564,362	19,958,894
Sigurime shoq. E shend.	2,048,476	4,741,368
TAP	439,910	7,253,876
Tatim fitimin	33,954,385	7,225,701
Tatim ne burim	2,307,528	3,685,968

TVSH	-	10,952,860
Hua te tjera	-	92,527,293
Parapagimet e arketuara dhe garanci	5,133,527	30,200,439
Debitor e Kreditor te tjere	4,116,302	4,116,302
	337,195,277	492,803,577

- Sigurime shoqerore me vlere 2,048,476 leke, i perket detyrimit te muajit Dhjetor dhe muajve te tjere te vitit ushtrimor 2014 te palikujduara deri me 31.12.2014. Gjate vitit kontributet jane llogaritur sakte dhe derdhur rregullisht ne tatime.
- Detyrime tatimore me vlere 38,750,299 leke, perbehen nga detyrimet per tatimin e mbajtur nga pagat e personelit sipas listes pageses per vitin ushtrimor 2014, ne shumen 439,910 leke, tatim fitimi ne shumen 733,954,385 leke, tatim ne burim ne shumen 2,307,528 leke dhe kontribute shoqerore 2,048,476 leke.

7. DETYRIMET AFAT GJATA

Llogaria "Hua afat gjata nga banka me vleren 150,720,580 leke, perben detyrimin e shoqerise per huane e mare nga banka Intesa me interesa. Ky ze ka pesuar ndryshime ne ulje gjate vitit 2014 ne shumen 84,758,248 leke.

8. KAPITALI I AKSIONAR

Ne vitin 2014, kapitali i nenshkruar i shoqerise as eshte rritur e as eshte pakesuar me fitimet e realizuara ne vitin 2013. Regjistrimi i kapitalit eshte bere ne perputhje me Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", sipas vendimit te ortakeve te shoqerise dhe eshte depozituar prane QKR.

9. TE ARDHURAT

Te ardhurat analizohen sipas zerave ne tabelen e meposhteme :

	Viti 2014	Viti 2013
Shitjet neto (Produkte dhe punime)	1,479,592,167	377,225,003
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	1,527,120	7,890,451
Te tjera	10,630,902	7,453,034
Ndryshim gjendje produkte te gateshme	3,615,625	13,673,665

Te ardhurat ne menyre analitike paraqiten si me poshte :

Nr.	Shitje produkte e material te tjera	Leke
1	Shitje rere	911,286
2	Shitje beton	941,517
3	Shitje parafabrike	18,274,941
4	Shitje materiale dhe furnitura	725,171
	TOTAL	20,852,915

Nr.	Projekte ne infrastrukture ndertimi publike dhe private	Leke
1	Punime ne Hidrocentralin e Devollit	1,458,739,272
2	Punime per vete	9,936,600
3		
4		
5		
6		
TOTAL		1,468,675,872

Nr.	Te ardhura te tjera	Leke
1	Transport per te trete	496,683
2	Shitje AAGJ (Te ardhura neto)	694,302
3	Te tjera	1,030,437
4		
TOTAL		2,221,422

10. PERSONELI

Shoqeria ka 152 punonjes ne fund te periudhes ushtrimore. Shpenzimet per paga analizohen ne tabelen e meposhteme. Shoqeria paguan vetem sigurimet e detyrueshme shoqerore dhe shendetsore per punonjesit e saj.

	Viti 2014	Viti 2013
Paga	95,337,563	50,647,497
Sigurime Shoqerore dhe shendetsore	14,689,161	8,074,554
Shpenzime te tjera	90,000	67,800

11 . Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2014 jane treguar ne pasqyrat perkatese te meposhteme.

1. Materiale te konsumuara

1	Blerje inerte	1,920,000
2	Blerje cemento	36,922,923
3	Blerje parafabrikate	4,773,770
4	Blerje beton	6,233,383

5	Blerje rrjet+hekur	62,245,610
6	Blerje materiale te tjera	196,891,772
7	Blerje karburant	120,242,508
13	Blerje te tjera	7,350
14	Ndryshimi i gjendjes se lendeve te para e materialeve inventareve	13,452,028
	TOTALI	442,689,344

2. FURNITURA, NENTRAJTIME E SHERBIME

1	Punime me nenkontraktore	251,183,591
2	Energji elektrike, uje	4,672,484
3	Qera	60,486,099
4	Prime sigurimi	3,555,000
5	Te ndryshme	98,817,518
6	Udhetime e dieta	25,044,765
7	Telefon	1,657,575
8	Sherbim transporti	43,533,717
9	Sherbime bankare	2,134,332
	Totali	491,085,081

3. SHPENZIME TE TJERA RRJEDHESE

1	Te tjera taksa e tatime	3,148,244
2	Penalitete e gjoba	41,158,813
3	Shpenzime te tjera	24,798,567
	Totali	69,105,624

12. TATIM FITIMI

Fitimi bruto para tatimit për vitin 2014 eshte 272,682,175 Lekë. Ky rezultat është rregulluar në përputhje me ligjet fiskale në fuqi për llogaritjen e Tatim fitimit, duke i shtuar shpenzimet e pazbriteshme, ne shumen 65,607,224 lekë, te perbere sipas tabelës se meposhteme:

Penalitete,gjoba,demshperblime	33,712,248
Gjoba Interesi	7,446,565
Shpenzime per guzhinen dhe zyrrat	15,196,569
Shpenzime te ndryshme pa dokumentacionin e nevojshem	9,251,842
TOTALI	65,607,224

Si rezultat i sistemimit të mësipërm, fitimi i tatueshem për vitin 2014 është 338,289,399 Lekë, dhe Tatimi mbi Fitimin i llogaritur është 50,743,410 Lekë. Per pasoje rezultati neto eshte fitim ne shumen 221,938,765 leke, i cili eshte pasqyruar ne postin perkates, ne perberje te kapitaleve. Detyrimi per tatimin mbi fitimin, ne shumen 50,743,410 leke, llogaritur sipas bilancit dhe sipas

deklarates vjetore te vitit 2014, është përfshirë në postin Detyrime Tatimore, si teprice midis tatimit te llogaritur dhe tatimit te paguar gjate vitit 2014 (shënimi 6).

13. Ngjarjet pas dates se bilancit kontabel.

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera pas dates se raportimit qe do te kerkonin rregullime dhe shenime shtese ne pasqyrat financiare.